



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 25

2002

Qershor

### P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 8895 datë 16.5.2002	Për dhënie amnistie ..... 809
Ligj nr. 8896 datë 16.5.2002	Për ratifikimin e “Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komunitetit European për Statusin e Projektit të Asistencës së Policisë së KE-së (ECPA) në Shqipëri” ..... 810

**LIGJ**  
**Nr. 8895, datë 16.5.2002**

**PËR DHËNIE AMNISTIE**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, pika 2 shkronja “ë” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

1. Amnistohen personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, personat e dënuar me kusht ose me gjobë.

2. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë nën moshën 18 vjeç, femrat që në datën 1 qershor 2002 kanë mbushur moshën 55 vjeç dhe meshkujt që kanë mbushur moshën 65 vjeç.

3. Amnistohen personat e dënuar me burgim ose me dënime më të buta, të cilëve në datën 1 qershor 2002 u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.

4. U zbriten 1/4 (përsëritësve të së njëjtës veprë penale u zbriten 1/8) e dënimit të mbetur të gjithë të dënuarve, të cilët nuk përfitojnë nga pikat e mësipërme të këtij neni.

**Neni 2**

Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79 të Kodit Penal dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;

b) veprat penale të parashikuara nga nenet 100, 101 pika 2, 102, 103 dhe 104 të Kodit Penal;

c) rrëmbim personi i parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal;

ç) trafikim të njerëzve, shfrytëzim prostitucioni, shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese, trafikim të femrave për prostitucion, të parashikuara nga nenet 110 shkronja “a”, 114, 114 shkronja “a” dhe 114 shkronja “b” të Kodit Penal;

d) veprat penale të parashikuara nga nenet 136, 139, 140 dhe 141 të Kodit Penal, si dhe për vjedhje të pronës ushtarake me pasojë vdekjen e parashikuar nga neni 59 pika 2 i Kodit Penal Ushtarak;

dh) gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte të parashikuara nga nenet 73, 74 dhe 75 të Kodit Penal;

e) tortura me pasoja të rënda të parashikuara nga neni 87 i Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe integritetit të parashikuara nga nenet 208, 209, 210, 211, 212, 217 dhe 218 të Kodit Penal;

f) krime kundër rendit kushtetues të parashikuara nga nenet 219, 220 dhe 221 të Kodit Penal.

g) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara nga nenet 226, 227, 228 dhe 229 të Kodit Penal;

gj) akte terroriste të parashikuara nga nenet 230 dhe 232 të Kodit Penal;

h) trafikim të armëve dhe municionit të parashikuara nga neni 278 shkronja “a” i Kodit Penal;

i) trafikim të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe narkotike të parashikuara nga nenet 283, 284, 284 shkronja “a”, 284 shkronja “c”, 286 pika 2 të Kodit Penal;

Neni 3

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, do të quhen të dënuar:

- a) personat e dënuar nga gjykata e shkallës së parë dhe që brenda afatit ligjor nuk është bërë ankim ose apel në gjykatën e apelit;
- b) personat e dënuar nga gjykata e apelit.

Neni 4

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, për veprat penale të kryera deri në datën 1 qershor 2002, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**LIGJ**

**Nr. 8896, datë 16.5.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR STATUSIN E PROJEKTIT TË ASISTENCËS SË POLICISË SË KE-SË (ECPA) NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për statusin e projektit të asistencës së policisë së KE-së (ECPA) në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3360, datë 4.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR STATUSIN E PROJEKTIT TË ASISTENCËS SË POLICISË SË KE-SË (ECPA) NË SHQIPËRI

Duke marrë në konsideratë Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit, nënshkruar në fillim të shtatorit 1992,

Duke marrë parasysh vendimin WP/2001/970/1/ miratuar nga Komisioni më 11 qershor 2001 në lidhje me ngritjen e një projekti të Asistencës së Policisë së KE-së (ECPA) në Shqipëri,

Duke theksuar se Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka rënë dakord me ngritjen e një projekti të Asistencës së Policisë së KE-së (ECPA) në Shqipëri,

Duke theksuar se vendimi i Komisionit për t'ia besuar udhëheqjen operationale të këtij misioni njerit prej Shteteve të tij Anëtare Spanjës,

Duke theksuar se një protokoll teknik do të përfundohet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe projektit ECPA dhe do të mbështetet nga Komisioni,

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni, përfaqësuar nga Kryetari i Delegacionit, më poshtë të referuara si Palët,

Ranë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

#### Qëllimi dhe përcaktimet

Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të aplikohen për stafin civil dhe policor dhe për të mirat materiale dhe asetet e stafit/departamenteve të Komisionit të përfshira në këtë operacion ku ata veprojnë në kuadrin e operacionit.

Palët Kontraktuese mund të bëjnë rregullime të mëtejshme për të përcaktuar rregulla dhe procedura për operacionin, i cili do të marrë gjithashtu në konsideratë kursin e tij pasues.

Nëse nuk parashikohet ndryshe, dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe çdo angazhim i marrë nga autoritetet, si dhe privilegjet, imunitetet, lehtësirat ose koncesionet e dhëna ECPA-së ose njerit prej anëtarëve të saj në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen në Republikën e Shqipërisë.

Për qëllimet e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, termat e mëposhtëm përcaktohen si vijon:

(a) "ECPA"-ja nënkupton projektin e Asistencës Policore të KE-së (ECPA), që do të ngrihet në bazë të vendimit WP/2001/970/1/ të miratuar nga Komisioni më 11 qershor 2001.

(b) "Operacion" nënkupton mbështetje për misionin e AKPE-së, përgatitjen e tij dhe pjesëmarrjen në të. Qëllimi i këtij misioni është t'i sigurojë autoriteteve të policisë shqiptare informacionin dhe këshillimin e nevojshëm për aspektet e domosdoshme të funksioneve të policisë dhe të forcimit të rendit në sferat e organizimit, rendit publik, kontrollit kufitar dhe logjistikës dhe të propozojë modele trajnimi për këto subjekte.

(c) "Stafi i ECPA-së të KE-së" që marrin pjesë në misionet e ECPA-së apo në mbikëqyrjen e projektit në kontekstin e funksioneve të tyre zyrtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të stafit lokal të rekrutuar.

(d) "Stafi i Shteteve Anëtare të KE-së" nënkupton stafin civil dhe policor të vënë në dispozicion nga vendet pjesëmarrëse për projektin e ECPA-së.

(e) "Infrastruktura" nënkupton të gjitha ambientet dhe tokën e nevojshme për aktivitetet operationale, trainimin dhe administrimin e udhëhequr nga ECPA-ja për qëllimet e operacionit, si dhe akomodimin për stafin e ECPA-së.

(f) "Qeveria" nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

(g) "Vendi pjesëmarrës" nënkupton çdo Shtet Anëtar të KE-së që ve në dispozicion stafin për ECPA-në.

(h) "Të mirat dhe asetet e stafit/departamenteve të KE-së dhe Shteteve të tij Anëtare" nënkupton të mirat dhe asetet, të cilat janë pronë e stafit, departamenteve dhe trupave të KE-së dhe Shteteve të tij Anëtare ose që përdoren nga këto departamente dhe trupa dhe të cilat i jepen stafit të ECPA-së për kërkesat e operacionit.

(i) "Shtabi i Përgjithshëm i Komisionit dhe Përfaqësimi i Komisionit" nënkupton shtabin e përgjithshëm të Komisionit në Bruksel dhe Delegacionin e Komisionit në Shqipëri.

## Neni 2 Mandati

ECPA-ja duhet të synojë në sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme për policinë shqiptare, veçanërisht nëpërmjet sigurimit të vazhdimësisë së numrit të aksioneve të cilat janë përgatitur ose zbatuar nga Elementi Policor Këshillimor Shumëkombësh i Bashkimit të Europës Perëndimore (MAPE), në veçanti ato në lidhje me këshillin strategjik për autoritetet e Policisë Shqiptare dhe parashikimin e trainimit për zyrtarët e lartë të policisë.

ECPA-ja do të mbështesë, gjithashtu, përgatitjen e projekteve specifike në lidhje me policinë, që do zbatohen në kuadrin e programit CARDS dhe do të kontribuojë në zbatimin e Programit aktual të Policisë së PHARE-it.

ECPA-ja dhe Ministria e Rendit Publik do të marrin masat e nevojshme për të siguruar një lidhje të ngushtë dhe reciproke në nivelin e duhur.

## Neni 3 Angazhimet e ECPA-së

ECPA-ja angazhohet:

(a) të zbatojë, në përputhje me mandatin sipas nenit 2 dhe detajeve të programit në Aneksin 2;

(b) t'i raportojë rregullisht me shkrim Komisionit Europian dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për aktivitetet dhe rezultatet e ECPA-së, duke përfshirë zhvillimin e të gjithë projekteve të asistencës në zhvillim;

(c) të urdhërojë stafin e saj të mos shkelë ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe të përmbahen për çdo veprim që s'është në pajtim me natyrën këshillore të detyrave të tyre;

(d) të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të siguruar që anëtarët e stafit të saj, këshilltarë dhe konsulentë në Shqipëri, të mos merren me aktivitete që nuk pajtohen me qëllimet dhe objektivat e ECPA-së ose me thyerje të ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë;

(e) të bëjë temë konsultimi të ndërsjellë midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, KE-së dhe ECPA-së dhe me kërkesën e shprehur të Qeverisë, të marrë masa për thirrjen e një anëtari stafi ose këshilltari të huaj, i cili përfshihet në shkelje serioze të ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë ose në ndonjë aktivitet që është i papjtueshëm me qëllimin e ECPA-së;

(f) të lëshojë një kartë shërbimi për personelin që i përket ECPA-së, e cila vërteton statusin e tyre si të atashuar tek ECPA-ja dhe t'i sigurojë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë një listë të personelit të ECPA-së dhe ta informojë për mbërritjen dhe nisjen e personelit;

(g) të punësojë persona vendorë për pozicione të përshtatshme.

## Neni 4 Angazhimet e Qeverisë në lidhje me operacionin e ECPA-së

Në kuadrin e zbatimit të ECPA-së, Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakord dhe angazhohet:

(a) të emërojë homologët për secilën nga fushat kryesore të operacionit të ECPA-së;

(b) të përjashtojë ECPA-në nga të gjitha llojet e pagesave, taksave doganore, taksave, Taksës mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe ngarkesat e tjera që janë aktualisht në fuqi dhe të cilat mund të hyjnë në fuqi gjatë prezencës së ECPA-së në Shqipëri për automjetet, materialet, pajisjet dhe artikujt e tjerë të importuar në Shqipëri ose dhe të marra përsipër nga Elementi Policor Këshillimor Shumëkombësh të përmendur në nenin 1 paragrafi 1 për përdorimin e tyre zyrtar;

(c) të garantojë shpërndarje të menjëhershme në rast të importit ose eksportit nga (Shqipëria) apo për në Shqipëri;

(d) të përjashtojë pronën, të ardhurat dhe të mirat e tjera lokale të blera të ECPA-së nga të gjitha pagesat, taksat doganore, taksat, TVSH-në dhe ngarkesat e tjera që janë aktualisht në fuqi ose të cilat mund të hyjnë në fuqi gjatë prezencës së ECPA-së në Shqipëri;

(e) të përjashtojë ECPA-në nga gjithë ndalimet dhe kufizimet për importin, importet e përkohshme dhe eksportet në lidhje me artikujt e importuar ose eksportuar nga ECPA-ja për përdorim zyrtar dhe në lidhje me publikimin e tyre nëse artikujt e përmendur janë importuar ose eksportuar para deklarimit përmes doganës;

(f) ECPA-ja do të ketë të drejtën të shpërndajë dhe të marrë korrespondencën e saj me postë ose në pako, të cilat do të kenë të njëjtat imunitete dhe privilegje si posta dhe pakot diplomatike;

(g) ECPA-ja do të ketë pacenueshmërinë për të gjitha letrat dhe dokumentet që hyjnë apo dalin;

(h) ECPA-ja do të ketë të drejtën të imporojë, importojë përkohësisht ose eksportojë automjetet e veta, nëse është e nevojshme, për përdorimin e saj pa u bërë subjekt i regjistrimit ose licencimit të kërkuar, as të sigurimit tregtar;

(i) të pranojë si të vlefshme pa taksa ose pagesë, patentat e udhëtimit dhe licencat e leje të tjera të lëshuara për anëtarët e huaj të stafit të ECPA-së, nga autoritetet e tyre respektive kombëtare;

(j) të përjashtojë ECPA-në nga taksat doganore për importin, importin e përkohshëm dhe eksportin e publikimeve të ECPA-së, duke përfshirë fotografi të qëndrueshme dhe në lëvizje, regjistrimet zanore, sistemet e të dhënave dhe programet e kompiuterit të lidhura me aktivitetet e ECPA-së;

(k) t'i asistojë ECPA-së dhe anëtarëve ose këshilltarëve të stafit pas emërimit në Shqipëri, në përmbushjen e detyrave të tyre në Shqipëri dhe t'u lëshojë atyre, nëse mendohet e nevojshme, karta identiteti ose dokumente të tjera të duhura me qëllim që të lehtësojë përmbushjen e detyrave të tyre në Shqipëri;

(l) të autorizojë ECPA-në që të operojë me llogari bankare në valutë të huaj dhe të ndërmarrë operacione të huaja shkëmbimi, të tilla siç mund të kërkojnë, me qëllim që të përmbushë në mënyrë të kënaqshme aktevetet e saj ndërkombëtare, subjekt i ndonjë kontrolli shkëmbimi dhe rregulloreve për periudhën që janë në fuqi në Shqipëri;

(m) të asistojë ku është e mundur për të siguruar që komunikimi zyrtar i ECPA-së funksionon shumë mirë;

(n) të lejojë ECPA-në që të operojë me të gjitha llojet e lehtësive të komunikimit me radio dhe satelit;

(o) t'i japë ECPA-së dhe stafit të saj kombëtar dhe të huaj, automjeteve, pajisjeve, materialeve dhe gjërave personale, të gjithë mbrojtjen e kërkuar, falas, në rast se lind një nevojë e tillë;

(p) të përjashtojë ECPA-në nga të gjitha llojet e pagesave, taksave doganore, TVSH-ja dhe ngarkesat e tjera që janë aktualisht në fuqi dhe të cilat mund të hyjnë në fuqi gjatë prezencës së ECPA-së në Shqipëri për automjetet, materialet, pajisjet dhe artikujt e tjerë që janë importuar në Shqipëri nga ECPA-ja, për përdorim zyrtar dhe të cilat kanë humbur, janë vjedhur ose shkatërruar gjatë ekzekutimit të projekteve të ECPA-së në Shqipëri. Nëse ECPA-ja vendos të forcojë strukturat publike qendrore ose lokale duke i dhuruar pjesë të pasurisë së saj, janë të zbatueshme të njëjtat rregulla;

(q) të lejojë ECPA-në të mbajë flamurin dhe shenjën dalluese të BE-së mbi çdo uniformë, mjet transporti dhe lehtësi tjetër;

(r) stafi i huaj i ECPA-së mund të veshë uniforma me një shenjë dalluese dhe të mbajë armë zjarri, nëse konsiderohet e nevojshme nga Shefi i ECPA-së dhe në këtë rast të fundit, duke njoftuar Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe Shefin e Delegacionit të KE-së.

#### Neni 5

### **Privilegjet dhe imunitetet e ECPA-së dhe stafit të saj**

ECPA-ja dhe stafi i saj do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e siguruar nga ky Memorandum Mirëkuptimi, duke përfshirë Aneksin 1 të tij. ECPA-ja duhet të frenohet nga çdo aksion ose aktivitet i papajtueshëm me natyrën e paanshme dhe ndërkombëtare të detyrave të saj ose në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi. Ata do t'i përmbahen ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë deri sa këto janë në pajtim me mandatin e tyre. Shefi i ECPA-së do të marrë çdo masë të nevojshme për të siguruar që këto detyrime do të përmbushen.

Qeveria angazhohet të respektojë natyrën ekskluzivisht ndërkombëtare të ECPA-së. Gjatë aktiviteteve që do të bëhen në Shqipëri, ECPA-ja dhe stafi i saj do të kontaktojnë me autoritetet legjitime dhe lokale të Republikës së Shqipërisë dhe do të bashkëpunojnë me to.

Më përjashtim kur ky Memorandum Mirëkuptimi ose anekset e tij parashikojnë ndryshe, dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara të 13 janarit 1946, do të zbatohen mutandis ndaj stafit të ECPA-së. Të gjitha të mirat dhe asetet e KE-së dhe stafit/departamenteve të Shteteve Anëtare të KE-së prezente në Shqipëri në kontekstin e operacionit, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në këtë Konventë dhe këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Privilegjet dhe imunitetet e siguruar në këtë nen dhe në aneksin 1 do t'i jepen anëtarëve të huaj të stafit të Programit gjatë misionit të tyre dhe më pas në lidhje me aktet e parashikuara të përmbushura gjatë misionit të tyre.

#### Neni 6

### **Juridiksioni**

Gjithë stafi i ECPA-së do të gëzojë imunitetet nga procedimet ligjore në lidhje me veprimet e ndërmarra me kapacitetin e tij zyrtar (duke përfshirë të folurën dhe shkrimin). Ai do të vazhdojë të gëzojë këtë imunitet edhe pasi të ketë pushuar së qeni anëtar ose i punësuar nga ECPA-ja, dhe pasi të gjitha dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të pushojnë së zbatuari.

Si ekspertë në mision, stafi i ECPA-së do të gëzojë imunitetet nga arrestimi apo paraburgimi. Stafi i ECPA-së i arrestuar apo i paraburgosur gabimisht, duhet t'i dorëzohet menjëherë autoriteteve të ECPA-së.

Nëse Qeveria konsideron që një anëtar i ECPA-së ka kryer një shkelje kriminale, ajo do të informojë menjëherë Shefin e ECPA-së dhe do t'i paraqesë çdo evidencë që mund të ketë për shkelje kriminale.

Në bazë të dispozitave të nenit 2 (3), stafi i ECPA-së në të gjitha rrethanat dhe në çdo kohë do t'i përgjigjet vetëm përfaqësuesve të tij kombëtarë çdo shkelje kriminale ose veprim të gabuar që mund të bëjë në territorin e Republikës së Shqipërisë, derisa, për arsye të natyrës së shkeljes, shteti i tij vendos të mos ushtrojë autoritetin e tij, por t'ia transferojë atë Qeverisë sipas një procedure ekstradimi.

ECPA-ja dhe autoritetet e Republikës së Shqipërisë do t'i japin njëra-tjetrës asistencë të ndërsjellë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve respektive. Vendet pjesëmarrëse do të informojnë Qeverinë për çdo procedim ligjor të ngritur ndaj anëtarëve të ECPA-së të cilët kanë kryer një shkelje kriminale.

#### Neni 7

### **Kushtet e nevojshme për aktivitetet operacionale dhe administrative të ECPA-së dhe akomodimi i stafit: paprekshmëritë e ambienteve të ECPA-së**

Vetëm Drejtuesi i ECPA-së mund të autorizojë përfaqësues të autoriteteve publike apo këdo tjetër i cili nuk i përket ECPA-së të hyjë në këto ambiente.

Nëse lind nevoja, ECPA-ja ka të drejtë të prodhojë, të transmetojë dhe të shpërndajë elektricitet për nevojat e saj në ambientet e veta.

#### Neni 8

### **Kërkesat për kompensim dhe procedurat ligjore**

Nëse stafi i ECPA-së apo prona e saj, cenohet apo dëmtohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, stafi i saj apo nga shtetasit shqiptarë, çdo vend që kontribuon në ECPA mund, në përjashtim të rasteve serioze të qëllimshme, të ngrejë pretendime për kompensim dhe rimbursim të dëmtimeve.

Kërkesat për kompensim për cenimet e shkaktuara apo dëmtime bërë përkundrajt stafit apo pronës të Qverisë, ose shtetasve shqiptarë dhe pronës së tyre, do të dërgohen nëpërmjet autoriteteve shqiptare tek drejtuesi i ECPA-së dhe të përcaktuara si më poshtë:

(a) Procedurat në lidhje me kërkesat për kompensim dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të dalin si pasojë e akteve apo ngjarjeve të dëmshme për Republikën e Shqipërisë, për shtetasit shqiptarë dhe personat legalë, të shkaktuara nga ECPA-ja apo anëtarë të saj, si dhe procedurat për pretendimet për kompensim të ECPA-së, do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë.

(b) Kërkesat për kompensim, të ardhura si pasojë e aktiviteteve të lidhura me shqetësimet civile, mbrojtjen e ECPA-së, me lëshimin ose dhënien e armëve apo nevojat operative, (të tilla si aktivitete që sigurojnë ndihmën dhe zbatimin e operacionit, pjesëmarrjen e ECPA-së dhe stafit të saj në këtë operacion, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e ECPA-së) nuk do të pranohen dhe nuk do të kenë të drejtën e pagesës së kompensimit.

(c) Nëse veprimi civil ngrihet në një gjykatë shqiptare kundër anëtarëve të ECPA-së Drejtuesi i ECPA-së duhet të lajmërohet menjëherë, dhe ai duhet t'i vërtetojë gjykatës nëse çështja ka ose nuk ka lidhje me funksionet apo detyrat zyrtare të personit në fjalë.

(d) Nëse Drejtuesi i ECPA-së vërteton që veprimi civil i paraqitur ka lidhje me detyrat dhe funksionet zyrtare, çështja do të mbyllet. Në rast të kundërt, kur mosmarrëveshjet apo kërkesat për kompensim mbulohen nga ligji privat ku ECPA-ja apo anëtarët e saj bëjnë pjesë, dhe ku gjykata shqiptare nuk ka autoritet sipas dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi ato do të zgjidhen sipas një komiteti të ngritur për këtë qëllim, sipas një vendimi të marrë në bazë të nenit 1.2.

(e) Nëse Drejtuesi i ECPA-së vërteton që veprimi i paraqitur nuk ka lidhje me detyrat dhe funksionet zyrtare, procedimi mund të vazhdojë. Nëse drejtuesi e ECPA-së vërteton që një anëtar i ECPA-së nuk është në gjendje të mbrojë interesat e tij përgjatë procedimit për shkak të funksioneve të tij zyrtare apo për shkak të një mungese të autorizuar, gjykata do të ndërpresë procedimin deri sa ai të mund të mbrojë veten e tij, por jo më shumë se nëntëdhjetë ditë. Prona e një anëtari të tillë të ECPA-së, e cila vërtetohet nga Drejtuesi i ECPA-së si e nevojshme për ekzekutimin e detyrave të tij funksionale zyrtare, nuk do të merret në shqyrtim në zbatimin e gjykimit apo të vendimit të gjykatës. Nëse një veprim civil paraqet, nuk do të ketë kufizime të lirisë personale të një anëtari të ECPA-së në rast të zbatimit të një vendimi apo gjykimi të gjykatës, për administrimin e një betimi apo për ndonjë tjetër arsye.

#### Neni 9

### **Dispozitat, mbështetja me shërbime dhe të mira materiale, shëndeti dhe kushtet sanitare**

ECPA-ja do të përjashtohet nga taksat e përgjithshme të shitjes në lidhje me blerjet e saj zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

ECPA-ja dhe Qeveria do të bashkëpunojnë për shërbimet shëndetësore dhe në mënyrë të plotë për çështjet në lidhje me shëndetin, në mënyrë të veçantë në kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në përputhje me konventat ndërkombëtare.

ECPA-ja do të autorizohet të konkludojë kontrata të drejtëpërdrejta, të përjashtuara nga gjithë taksat dhe akcizat me ofruesit e të mirave materiale dhe shërbimeve në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 10

#### **Komunikimi**

Qeveria pranon që operacioni kërkon përdorimin e mjeteve të komunikimit. ECPA-ja do të autorizohet të përdorë postën e saj të brendshme dhe shërbimet e telekomunikacionit.

Ky autorizim do të përfshijë të drejtën për të përdorur sisteme të informacionit e komunikimit të nevojshëm për të garantuar një kapacitet të plotë komunikimi dhe të drejtën të përdorë spektrin e plotë elektromagnetik pa pagesë për këtë qëllim. Në ushtrimin e të drejtave, ECPA-ja do të bëjë çdo gjë të arsyeshme brenda limiteve të saj për të koordinuar me autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe për të marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e tyre.

Autoritetet shqiptare do të ndihmojnë Drejtuesin e misionit në rastet kur ai ka nevojë të përdorë sistemet lokal, të informacionit e komunikimit (qarqe, pajisje, faks dhe telefon).

#### Neni 11

#### **Ndërlidhja**

Shefi i ECPA-së dhe Qeveria do të marrin masat e duhura për t'u lidhur në mënyrë të ngushtë dhe reciproke në nivelin e duhur.

#### Neni 12

#### **Mosmarrëveshjet**

Çdo lloj mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin ose aplikimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, e cila nuk mund të zgjidhet me anë të negociatave direkte, do të zgjidhet ekskluzivisht nëpërmjet kanaleve diplomatike midis Shqipërisë dhe Komisionit, përveç rasteve për të cilat është rënë dakord.

Mosmarrëveshjet në lidhje kushtet e punësimit dhe të shërbimit të stafit të punësuar lokal do të zgjidhen me anë të procedurave administrative, të cilat do të themelohen nga Shefi i ECPA-së dhe Autoritetet Shqiptare.

#### Neni 13

#### **Dispozitat përfundimtare**

Qeveria e Shqipërisë do të pranojë përgjegjësinë ligjore për të gjitha aktivitetet e ECPA-së dhe për personelin e saj, të cilat kryhen në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, si edhe për ndonjë veprim të ndërmarrë në mënyrë direkte ose jo direkte, në përgjigje të raporteve ose rekomandimeve të ECPA-së ose personelit.

Qeveria e Shqipërisë do t'i sigurojë Komisionit European të gjithë informacionin në lidhje me aplikimin e këtij Memorandum Mirëkuptimi dhe kur të jetë e nevojshme do të ofrojë bashkëpunim të plotë, mbrojtje dhe asistencën e nevojshme për plotësimin e detyrave të ECPA-së siç është specifikuar në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet në fuqi për aq kohë sa Qeveria e Shqipërisë ose Komisioni European të informojë tjetrën, 60 ditë më përpara, për qëllimin e saj për përfundimin e këtij Memorandum Mirëkuptimi. Neni 2 paragrafi 2 dhe shtojca 1 (a) dhe (c) do të mbeten në fuqi pas përfundimit.

Sa herë që ky Memorandum Mirëkuptimi i referohet privilegjeve, imuniteteve dhe detyrave të ECPA-së dhe stafit të saj ose për lehtësirat të cilat i ndërmerr Qeveria për t'i bërë të vlefshme për ECPA-në, Qeveria do të ketë përgjegjësi të plotë për të siguruar këto privilegje, imunitete, të drejta dhe lehtësira të zbatohen dhe aplikohen nga autoritetet kompetente lokale në Republikën e Shqipërisë.

Secila Palë e këtij Memorandumi të Marrëveshjes mund të propozojë amendamente për ndonjërin nga dispozitat e tij. Këto amendamente do të hyjnë në fuqi me pranimin me shkrim nga Republika e Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane.

Përsa më sipër,

Përfaqësuesit e Palëve, referuar sa më poshtë, kanë nënshkruar këtë Memorandum të Marrëveshjes.

Bërë në Tiranë në \_\_\_\_\_ në dy kopje në gjuhën angleze, njëra prej dy kopjeve të nënshkruara do të vendoset në arkivat e Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe kopja tjetër do të mbahet nga Qeveria e Shqipërisë.

Për Komisionin  
Kryetari i Delegacionit në Shqipëri

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë  
Ministria e Rendit Publik

## SHTOJCA 1

### VEPRIMET QË DO TË NDËRMERREN NGA QEVERIA NË LIDHJE ME ANËTARËT E STAFIT, KËSHILLTARËT, KONSULENTËT E ECPA-SË, TË CILËT NUK JANË SHTETAS TË SHQIPËRISË

Në lidhje me Shefin e ECPA-së, anëtarët e stafit, këshilltarët, konsulentët dhe për pjesën tjetër të personelit të ECPA-së, të cilët nuk janë shtetas të Shqipërisë ose rezident në Shqipëri, vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Shqipërisë ndërmerr:

(a) të garantojë përjashtimin nga të gjitha taksat e të ardhurave, detyrimeve të pagesës dhe të gjitha llojeve të tjera të detyrimeve për pagesë, si edhe për kontributin për sistemet e sigurimeve shoqërore;

(b) t'i përjashtojë ata nga pagesat e taksave, faturave, detyrimeve të cilat përdoren në aeroporte dhe që kanë lidhje me shërbimet e aeroportit, rrugëve dhe porteve;

(c) t'i përjashtojë ata nga pagesat e importit, doganave dhe detyrimeve të tjera, për mjetet e tyre të reja ose të përdorura personale dhe shtëpiake ose për ndonjë lloj tjetër të mirash ose pajisjesh për përdorim personal. Në rastet kur sigurohet që ndonjë prej këtyre të mirave ose mallrave personale shitet ose nuk përdoret më në Shqipëri, pavarësisht nëse është një person ose një organizatë e privilegjuar, detyrimet dhe taksat do të paguhen në përputhje me klauzolat përkatëse;

(d) të garantojë ata me përjashtimin nga obligimet e shërbimeve kombëtare, regjistrimi për të huajt dhe nga detyrimet e imigracionit;

(e) të krijojë lehtësira të tilla riatdhesimi për ta në raste krizash, ashtu siç krijohen nga Qeveria për personelin e asistencës teknike;

(f) t'i lejojë ata ose vartësit e tyre të sjellin në Shqipëri një shumë të arsyeshme të monedhave të huaja për përdorim personal, të riatdhesojë këto shuma nga Shqipëria nën përdorimin e lehtësirave dhe mundësirave të llogarive të jashtme, në përputhje me rregulloret egzistuese të Shqipërisë, për shkëmbimin e huaj;

(g) t'i lejojë ata për të udhëtuar, lëvizur dhe komunikuar lirshëm brenda territorit të Shqipërisë, si edhe të mos paguajnë kur hyjnë ose largohen nga Shqipëria.

(i) stafi i huaj i Programit do të gëzojë mosçenimin e personelit nga juridiksioni civil, administrativ dhe kriminal.

**VEPRIMET QË DO TË NDËRMERREN NGA QEVERIA NË LIDHJE ME ANËTARËT E STAFIT, KËSHILLTARËT DHE KONSULENTËT E ECPA-SË, TË CILËT JANË SHTETAS TË SHQIPËRISË**

Anëtarët e stafit, këshilltarët, konsulentët ose pjesa tjetër e personelit të ECPA-së, të cilët janë shtetas ose rezidentë në Shqipëri:

(j) do të jenë të përjashtuar nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe nga të gjitha aktet e kryera prej tyre në kapacitetin e tyre zyrtar.

**SHTOJCA 2**

**PËRSHKRIMI I OPERACIONIT  
PROJEKTI I ASISTENCËS POLICORE TË KËSHILLIT TË EUROPËS  
NË SHQIPËRI (ECPA) 2001/2002**

**1. HISTORIKU**

Operacioni MAPE përfundoi më 31 maj 2001. Një program, i drejtuar nën programin CARDS, ndërmjet të tjerash, përfshin çështjet e mbuluara nga MAPE, program i cili po përgatitet dhe është planifikuar të operojë gjatë vitit 2002.

Me qëllim që të bëjë lidhjen midis periudhës së përfundimit të operacionit MAPE dhe të fillimit të një programi të plotë nën programin CARDS, Komisioni Europian (këtu i ashtuquajtur Komisioni) ka përgatitur një projekt specifik për periudhën 2001-2002, p.sh: Projekti i Asistencës Policore i Këshillit të Europës (ECPA).

Projekti do të ketë si qëllim të sigurojë një mbështetje të vazhdueshme për Policinë Shqiptare, kryesisht duke siguruar vazhdimësinë e nevojshme të një numri veprimesh të përgatitura/të implementuara nën operacionin MAPE, në veçanti ato që kanë lidhje me këshillimin strategjik për autoritetet e policisë shqiptare dhe të sigurojë trainim për zyrtarët e lartë të policisë. ECPA-ja gjithashtu, do të mbështesë përgatitjen e projekteve që kanë lidhje specifike me policinë, të cilat do të implementohen në kuadrin e programit CARDS.

Për implementimin e projektit, Shtetet Anëtare propozojnë ekspertë të cilët të kryejnë detyrat e parashikuara nën ECPA.

**2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT**

Për implementimin e Projektit, duhet të krijohet një ekip menaxhimi (përfshirë drejtuesin e Projektit) + 4 ekipe teknike. Numri total i ekspertëve nuk duhet të jetë mbi 30. Ekipet do të operojnë kryesisht në Tiranë, por gjithashtu duhet të jenë në gjendje të implementojnë aksione/veprime në të gjithë Shqipërinë.

Drejtuesi i Projektit do të veprojë si një koordinator i përgjithshëm dhe do të ketë përgjegjësi për implementimin e projektit. Ai/ajo do të jetë drejtuesi kryesor si për autoritetet shqiptare ashtu edhe për Komisionin. Ai/ajo do t'i raportojë Komisionit dhe autoriteteteve përkatëse shqiptare (tri raporte gjatë vitit dhe një raport final). Këto raporte do t'i paraqiten dhe do të jenë të vlefshme për Këshillin.

Drejtuesi i Projektit do të jetë përgjegjës për aspektet teknike të operacionit. Aspektet e politikave/rregulloreve do të jenë nën përgjegjësinë e Komisionit.

Një Komitet Drejtues do të krijohet për orientimet e përgjithshme, për shkëmbimin e informacionit dhe për implementimin e këtij Projekti. Autoritetet shqiptare, Drejtuesit e Projektit, Shtetet Anëtare dhe Komisioni do të marrin pjesë në Komitetin Drejtues.

Drejtuesi i Projektit, gjithashtu, do të jetë përgjegjës për menaxhimin e financimit të fondeve të Bashkimit Europian.

Secili ekip do të jetë përgjegjës për implementimin e detyrave specifike dhe do të përbëhet nga ekspertë me historikun dhe ekspertizën e nevojshme për të përmbushur këto detyra.

Secili ekip raporton nëpërmjet Drejtuesit të Ekipit të tij tek Drejtuesi i Projektit, i cili nga ana e tij i raporton Komisionit dhe Autoriteteve Shqiptare.

Për implementimin e trainimit mbi teknikat specifike policore, Shteteve Anëtare, gjithashtu, do t'iu kërkohet që të sigurojnë ekspertë për periudha afatshkurtra. Kohëzgjatja e qëndrimit në Shqipëri për shpërndarjen dhe kryerjen e kurseve është përcaktuar dhe ndarë në javë të ndryshme.

**Në bazë të një marrëveshjeje midis Këshillit të Europës dhe autoriteteve shqiptare, pajisjet dhe mjetet të cilat do të përdoren për këtë projekt, mbahen në Shqipëri derisa të fillojë Projekti.**

**Ekipi 1 - Menaxhimi:** ky ekip do të ketë si detyrë të menaxhojë aspektet operacionale, logjistike dhe financiare të projektit.

**Ekipi 2 – Zhvillimi Strategjik + Ndërtimi Institucional:** ky ekip në veçanti:

1) do të këshillojë për përgatitjen e plan aksioneve të nevojshme, të cilat kërkohen për të implementuar Strategjinë e Reformës Policore të adaptuar kohët e fundit;

2) do të ndihmojë autoritetet shqiptare për të zhvilluar dhe implementuar një plan aksion specifik, i cili mbështet nxitjen e bashkëpunimit midis trupave të zbatimit të ligjit, përfshirë policinë kufitare, doganat, prokurorinë e përgjithshme dhe gjyqësorin;

3) do të zhvillojë strategjinë për të luftuar kundër krimit të organizuar;

4) do të sigurojë koordinimin e duhur me aktivitetet ndërkombëtare, që janë në proces në fushën e policisë;

5) do të zhvillojë një funksionim të dhënies së llogarisë dhe funksionim të kontrollit të brendshëm brenda radhëve të policisë shqiptare;

6) sigurojë mbështetje për implementimin e akteve ligjore kryesore, të cilat rregullojnë punën e policisë, përfshirë çështjet që kanë lidhje me organizimin, seleksionimin, menaxhimin e stafit, masat disiplinore dhe anti-korrupsion;

7) do të identifikojë nevojat afatshkurtra dhe afatgjata për ndërtimin e institucioneve për policinë shqiptare;

8) në bashkëpunim të ngushtë me ekipet 3,4 dhe 5, të sigurojë mbështetje dhe bashkëpunim dhe të implementojë Programet PHARE/CADRS në fushën e Policisë, Drejtorisë së Punëve të Brendshme dhe Ndërtimit Institucional.

**Ekipi 3 – Trajnimi për Nivelin e Lartë/Teknikat Speciale:** ky ekip në veçanti do të:

1) merret me trainimin e zyrtarëve të nivelit të lartë të policisë;

2) të shpërndajë dhe kryejë trainimet mbi teknikat specifike policore (siç është lufta kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të qenieve njerzore, drogave, çështjet që kanë lidhje me emigracionin...). Ekspertët afatshkurtër do të përdoren për këtë detyrë;

3) në bashkëpunim të ngushtë me ekipet 1 dhe 2, do të ngarkohet për zhvillimin e përgatitjes së Curricula/autobiografisë.

**Ekipi 4 – Sistemet e Informacionit dhe Infrastruktura:** ky ekip do të fokusohet mbi:

1) vlerësimin e sistemeve kohorente të informacionit në Shqipëri;

2) dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të informacionit;

3) zhvillimin e konceptit të analizave të vështira;

4) identifikimin e nevojave më urgjente për teknikat e informacionit, përfshirë zhvillimin e specifikimeve teknike për prokurimin, në përputhje me standardet europiane;

5) identifikimin e nevojave më urgjente të infrastrukturës.

**Ekipi 5 – Zhvillimi Organizativ:** ky ekip në veçanti:

1) do të asistojë autoritetet shqiptare në zhvillimin e një policie kufitare sa më efikase;

2) do të asistojë autoritetet shqiptare në zhvillimin e shërbimeve adekuate mbështetëse (logjistikë, mirëmbajtjen e materialeve...).

3) do të asistojë autoritetet shqiptare në themelimin e një sistemi të saktë paraburgimi.

### **3. OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË PROJEKTIT**

1) Të këshillojë mbi përgatitjen e plan aksioneve të nevojshme, të cilat kërkohen për implementimin e Strategjisë së Reformës së Policisë të adaptuar kohët e fundit;

2) të sigurojë mbështetje për përgatitjen dhe implementimin e Programeve PHARE/CARDS në fushën e policisë, drejtorisë dhe punëve të brendshme dhe ndërtimin e institucioneve;

3) të ndihmojë autoritetet shqiptare për të zhvilluar dhe implementuar plan aksion specifik, i cili mbështet nxitjen e bashkëpunimit midis trupave të zbatimit të ligjit, përfshirë policinë kufitare, doganat, Prokurorinë e Përgjithshme dhe gjyqësorin;

4) të zhvillojë strategjitë për të luftuar krimin e organizuar

5) të sigurojë koordinimin e duhur me aktivitetet e tjera ndërkombëtare që janë nën proces, në fushën e policisë;

6) të zhvillojë një funksionim të dhënies së llogarisë dhe të kontrollit të brendshëm brenda radhëve të policisë shqiptare;

7) të sigurojë mbështetje për implementimin e akteve kryesore ligjore, të cilat rregullojnë punën e policisë, përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, seleksionimin, menaxhimin e stafit, masat disiplinore dhe antikorupsion;

8) të identifikojë nevojat për ndërtimin institucional afatshkurtra dhe afat mesme;

9) të shpërndajë dhe kryejë trainime për zyrtarët e nivelit të lartë të policisë;

10) të shpërndajë dhe kryejë trainime mbi teknikat specifike policore (siç është lufta kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të qenieve njerëzore, drogave, çështjeve që kanë të bëjnë me emigracionin...);

11) të përgatisë sisteme koherente të informacionit në Shqipëri;

12) të vlerësojë sistemet koherente të informacionit në Shqipëri;

13) të përgatisë rekomandime për përmirësimin e sistemeve të informacionit;

14) të zhvillojë konceptin e analizave të vështira;

15) të identifikojë nevojat më urgjente të informacionit, përfshirë zhvillimin e specifikimeve teknike për prokurim, në përputhje me standardet europiane;

16) të identifikojë nevojat më urgjente të infrastrukturës;

17) të asistojë autoritetet shqiptare në zhvillimin e një policie kufitare sa më efektive;

18) të asistojë autoritetet shqiptare në zhvillimin e shërbimeve mbështetëse adekuate (logjistike, mirëmbajtjen e materialeve,...);

19) të asistojë autoritetet shqiptare në themelimin e një sistemi të saktë parburgimi.

### **4. PREZUMIMET MADHORE**

ECPA-ja:

(a) do ndërmarrë, duke pasur miratimin dhe bashkëpunimin e ngushtë të Qeverisë Shqiptare, përcaktimin e modeleve të nevojshme për policinë dhe drejtësinë penale, sistemet mbështetëse dhe procedurat që kërkohen të adaptohen;

(b) do të angazhojë personelin e ECPA-së kryesisht në Tiranë, por gjithashtu të veprojë jashtë Tiranës, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë sigurisë së personelit;

(c) nuk do ta përfshijë ECPA-në në ndonjë zbatim direkt të ligjit shqiptar;

(d) do të shihet në një kontekst më të gjerë dëshira e komunitetit ndërkombëtar për stabilizimin e rajonit dhe të integritetit eventual të Shqipërisë në Bashkimin Europian;

(e) do të kërkojë që i gjithë personeli i emëruar, duke pasur kontributin e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, duhet që të kryejë detyrën e tij në një mënyrë sa më të saktë dhe të plotë, si dhe të jetë një personel me cilësi shumë të lartë;

(f) do të punojë në partneritetin me Autoritetet Shqiptare deri në atë masë sa punojnë Autoritetet Shqiptare në partneritet me stafin e ECPA-së në projektet e përbashkëta;

(g) do të punojë në bashkëpunim me koordinim me misionet multilaterale dhe bilaterale në Shqipëri.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 13.6.2002  
Doli nga shtypi më 14.6.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë